



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 985/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rruga “Armend Daci” nr. 1 Prishtinë, kundër debitorit “G...” sh.p.k, me nr. biznesi, me pronar V.A, Komuna e Lipjanit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.1450/2021 të datës 12.10.2021, të Përbaruesit Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 18.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “G...” sh.p.k, me nr. biznesi, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.1450/2021 i datës 12.10.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Valdrin Beka, për pjesën e kamatës në lartësi prej 2 % në emër të interesit mujor.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përbarimit P.nr.1450/2021 i datës 12.10.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Valdrin Beka, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 11,844.68 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e katër dhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë e tetë cent).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndaj debitorit “G...” sh.p.k, me nr. biznesi, sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.1450/2021 i datës 12.10.2021, të Përbaruesit Privat Valdrin Beka, për pjesën e kamatës në lartësi prej 2 % në emër të interesit mujor.

A r s y e t i m

Kreditori, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka parashtruar propozim për përmbaram kundër debitorit “G...” sh.p.k, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbarues – aktvendimit të Komisionit për Miniera dhe Minerale për mos pagesë të rentës, me nr. 5294 data 14.12.2020, i formës së prerë nga data 08.08.2021 dhe i ekzekutueshëm prej data 25.08.2021, me të cilën debitori është obliguar që në emër të rentës minerare t’ia paguaj gjithsej vlerën në lartësi prej 11,844.68 €.

Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.1450/21 të data 12.10.2021, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues - Aktvendimit të Komisionit për Miniera dhe Minerale, për mos pagesë të rentës, me të cilin është detyruar debitori që në emër të rentës minerare t’ia paguaj gjithsej vlerën në lartësi prej 11,844.68 €, duke përfshirë edhe rrjedhën e interesit mujor prej 2% për qind e cila do të llogaritet nga departamenti i Financave – Divizioni i të Hyrave të KPMM –së, në emër të borxhit për mos pagesë të rentës.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, në të cilin ka deklaruar se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Ka shtuar se urdhri nuk është i ligjshëm dhe i rregullt dhe i njëjti është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Përmbarimore ngase përmbaruesi e ka lejuar urdhrin në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 22 par 1 nën par 1.2 dhe nenit 24 par 3 të LPP –së. Më tutje ka deklaruar se njoftimi për dështim i është lëshuar debitorit me arsyetimin se i njëjti ka dështuar në realizimin e detyrimeve ligjore për mos pagesën e rentës minerale si rezultat i posedimit të Licencës së shfrytëzimit me numër 1545/KPMM/2015, mirëpo sa i përket kësaj çështjeje, ka theksuar se debitori fare nuk e shfrytëzon këtë licencë, pasi që i njëjti licencën e ka transferuar/ bartur tek subjekti N... sh.p.k. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit i parashtruar kundër urdhrin për përmbaram të përmbaruesit privat Valdrin Beka dhe të shfuqizohet urdhri për përmbaram me P.nr. 1450/21 i datës 12.10.2021.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se propozimi për përmbaram është bërë sipas aktvendimit për mos pagesën e rentës minerare, duke

theksuar se kreditori e ka njoftuar debitorin si bartës të licencës se e i njëjti ka dështuar të bëjë pagesën e rentës. Ndërsa sa i përket pretendimeve të debitorit se i njëjti nuk ka qenë shfrytëzues i licencës dhe se të njëjtën e ka transferuar tek N... Sh.p.k., ka theksuar se këto pretendime nuk janë objekt i procedurës përmbare, por mund të jenë objekt i procedurës administrative apo asaj kontestimore. Më tutje ka shtuar në kuptim të nenit 1 par 2 nenit 21, nenit 22 par.1 nën par 1.2, nenit 23 par 2, 24 par 3, 27 par 1, 36 par 1 dhe 2 si dhe nenit 38 par 1 të LPP –së, ekziston baza ligjore e urdhrit për përmbare dhe me këtë rast kreditori konsideron se urdhri i organit përmbare është plotësisht i drejtë dhe i bazuar, duke theksuar se pretendimet e paraqitura në prapësim nuk bëjnë pjesë në shkaqet e prapësimi të paraparë sipas dispozitave të nenit 71 të LPP –së dhe si të tilla janë të pa bazuara dhe duhet të hedhen poshtë. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbare.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbare ka lejuar përmbaremin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbare e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaremin vetëm në bazë të dokumentit përmbare (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbare, përkatësisht – Aktvendimin e Komisionit për Miniera dhe Minerale, me nr. 5294 datë 14.12.2020, i cili është bërë i formës së prerë nga data 08.08.2021 dhe i ekzekutueshëm prej datës 25.08.2021, në bazë të së cilit përmbaresi privat ka lejuar përmbaremin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbare sipas të cilit mund të caktohet përmbaremi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu vendimi, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbare është i përshtatshëm për përmbare në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbareshjes*

së detyrimit”, pasi që janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret – aktvendimi i Komisionit për Miniera dhe Minerale me nr. 5294 i datës 14.12.2020, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase i njëjti është bërë i formës së prerë nga data 08.08.2021 dhe i ekzekutueshëm prej datës 25.08.2021,

Gjykata ka shqyrtuar urdhrin përmbarimor P.nr.1450/21 të data 12.10.2021, të Përmbaruesit Privat Valdrin Beka, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për kamatën në lartësi prej 2 % në emër të interesit mujor, dhe gjeti se me dokumentin përmbarimor sipas të cilit është lëshuar urdhri për përmbarim, debitori është obliguar që në emër të mos pagesës së rentës minerare t’ia paguaj kreditorit vetëm shumën prej 11,844.68 €, mirëpo jo edhe interesin mujore në lartësi prej 2% dhe meqenëse urdhri përmbarimor i lejuar për pjesën sa i përket kamatës në lartësi prej 2 % në emër të interesit mujor, nuk ishte në përputhje me dokumentin përmbarimor, gjykata të njëjtin e shfuqizoi pjesërisht duke vendosur si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin

e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.985/22, datë 18.11.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.